

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ***“Transport çakëll ”***

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**60100000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,746,374(tre milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa tvsh

4,495,648(katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP,i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2023-2024-2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për "Procedurës Tatimore "neni 64 Deklarata Tatimore.

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtetohët se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas percaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2026 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar percaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c,” Pasi cdo operator ekonomik duhet të ketë të paguara taksat dhe tarifatat vendore prane njësive të qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës, ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kesaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit se ka ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 ton deri 15 ton	4 copë	Pronësi ose me qera

(*Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve. Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.*)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme*
- 5. Certifikate per lejetransportiteleshuarnga Bashkia*

dhe permjetet me qera,

- 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj i cili te jete i vlefshem gjate periudhes se kryerjes se punimeve.*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*
- 6. Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

permjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.*
- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

c) Deklarate nga Operatori ekonomik per makineritë e mësipërme te cilat nuk duhet të jenë të angazhuara në kontratatet tjera.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Keto mjete janë të nevojshme për të bërë transportin e çakellit sipas kërkeses së autoritetit kontraktor. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Janë kërkuar 4 kamiona me kapacitet mbajtës sipas lejes së qarkullimit nga 10-15 ton duke marrë parasysh dhe sasinë e çakellit që do të transportohet sipas kërkeses së autoritetit kontraktor në destinacion.

OBJEKTI : TRANSPORT ÇAKELL PER RIPARIM RRUGE TE FSHATRAVE DHE PARCELAVE

Nr	Nr.An	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia
I		Transport material çakëll natyral deri 8 km. Distanca nga Shëngjergji		
	2.37/3b	Rruge parcele Pendavinj matanë varreve L=440x3.5x0.2	m3	306
II		Transport çakëll natyral deri 8 km . Distanca nga fshati Mesmal dhe degëzimi rruga e Strelcës		
	2.37/3b	Rruga e Mesmalit nga 3 urat dhe nga fshati Mesmal (Mbushje gropash) 571X3.5X0.2	m3	400
III		Transport material çakëll natyral deri 8 km . Distanca nga Zereci për Vrepckë dhe Vrepckë për Dushar		
	2.37/3b	Rruga Zerec -Dushar .(Mbushja gropa) L=571X3.5X0.2	m3	400
IV		Transport çakëll natyral në distancë 12 km Distanca nga Bregasi dhe Shëngjergji		
	2.37/5b 2.37/2a	Rruga e Qershizës pjesët e vështira L=333 ml x3x0.2	m3	200
	2.37/5b 2.37/2a	Rruga Orman në fshat L=1000 X3.5X0.2	m3	700
V		Transport material çakëll natyral 10 km . Distanca nga Bregasi dhe Shëngjergji		
	2.37/3b	Rruga poshtë kishës Zvirinë dhe Gorovec L=1600x3.5x0.2	m3	1120
	2.37/3b	Rruga e Muzhakave dhe e tre urave (mbushje gropash) L=300x3.5x0.2	m3	210
	2.37/3b	Rruga e 38-39-40 Sheqeras (mbushje gropash) L=700X3.5X0.2	m3	612
	2.37/3b	Rruga e bllokut 6 dhe 7 tokat e Vreshtasit poshtë Zvirinës L=500x3.5x0.2	m3	437

	2.37/3b	Rruga në periferi të Rëmbecit L=1000 x3.5x0.2	m3	700
VI		Transport çakëll natyral në distancë 20 km . Distanca nga Bregasi dhe Shëngjergji		
	2.37/5b 2.37/5b	Rruga e Kaskadës Vashtëmi L=1000X3.5X0.2	m3	875
	2.37/5b 2.37/5b	Rruga e Këmbëthekrit (mbushje gropa) L=250x3x0.2	m3	150
	2.37/5b 2.37/5b	Rruga e Goçës nga Bregasi (mbushje gropash) L=160X0.3X0.2	m3	96
VII		Transport çakëll distanca 24 km Bregas ose Shëngjergj		
	2.37/5b 2.37/5b	Rruga e Zboqërisë (mbushje gropash)L =250X3X0.2	m3	150
		Shuma	m3	6356

Sipas zërave të preventivit sasia e çakëllit për transport është 6356 m3.

1m3 çakëll=1.6 ton

*6356m3 *1.6ton/m3= 10170 ton*

10170 ton çakëll do transportohen për 44 ditë

10170 : 44 = 231 ton/ditë

Kamioni vetshkarkues me kapacitet mbajtës nga 10 deri në 15 ton

231 ton : 15 ton =15.4 rrugë në ditë

Duke qënë se nje kamion bën mesatarish 4 rrugë në ditë duhen gjithsej 4 kamion vetshkarkues

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën **4 punonjësish** për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

Dhe

- b. Listpagesate**konfirmuar (*me firmedhevule*) nga Administrata Tatimoretepunonjesvesipasformatitqekerkohetngalegjislacioni ne fuqi per muajin e fundit.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 4 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- Shofer kamioni (4)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronësi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Certifikate Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor
3. Leje Drejtimi kategoria C

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me shoferin(i cili duhet të ketë Certifikate Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor) deri në perfundimin e afateve të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Janë kerkuar minimalisht 4 persona, shofer kamioni, pasi janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve ,për transportin e çakellit në destinacionin e kerkuar.